



## LAJMËRIM PUBLIK

### SHITJA E VETURAVE TË UNHCR-së NËPËRMJET ANKANDIT PUBLIK

Zyra e Komesariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) në Kosovë shpall qëllimin e saj për shitjen nëpërmjet ankandit publik të veturave të përdorura Toyota (Auris, Prado, Land Cruiser, RAV4), Mitsubishi Outlander, Dacia Duster, Peugeot (308, 508), Skoda Superb dhe Renault Fluence.

- Shitia e veturave të cekura më lartë është subjekt i Kushteve për pjesëmarrje të cilat mund të mirren në lokacionin e cekur më poshtë.
- Secila veturë do t'i shitet ofertuesit më të lartë sipas parimit **“ashtu si është – aty ku është”**.
- Pjesëmarrja në ankandin publik është subjekt i pagesës së Tarifës/Depozitit për Regjistrim në vlerë prej **2,000 euro/veturë**. Kjo tarifë është e kthyeshme për pjesëmarrësit të cilët nuk shpallen fitues.
- Ofertuesit të cilët shpallen fitues duhet të kryejnë pagesën totale në afat prej **tri [3] ditësh** pune nga data e ankandit publik e cekur më poshtë.
- Shitia e veturave është subjekt i “Çmimit Rezervë”. UNHCR rezervon të drejtën të mos shpallë shitjen e veturës në rast se nuk arrihet ky Çmim Rezervë gjatë ofertimit.

Ankandi publik do të mbahet **të shtunën, 09 janar 2021 duke filluar nga ora 11:00** në këtë adresë: **Shtëpia e Ankandeve Kosova, Ndërtesa Iliria, Prishtinë-Graçanicë, Veternik, Prishtinë, 10060, Kosovë**.

Shikimi i veturave si dhe regjistrimi i pjesëmarrësve në ankand publik do të bëhet në lokacionin e lartpërmendor duke filluar nga **28 dhjetor 2020** nga ora 10:00 deri në 15:00 deri në ditën e ankandit publik.

Kontakti: **Shtëpia e Ankandeve Kosova, + 383 45 600 050.**

Për shkak të rregulloreve në fuqi lidhur me situatën pandemike, në ankand publik mund të marrin pjesë fizikisht më së shumti **110 persona**. Pranimi do të bëhet sipas renditjes së pranimit të depozitit në llogarinë bankare të Shtëpisë së Ankandeve Kosova.

Më tepër informata, përfshirë këtu edhe detajet e llogarisë bankare për pagesën e depozitave mund të merren në numrin e mësipërm apo edhe duke vizituar Shtëpinë e Ankandeve Kosova në adresën e cekur më lartë.

Pjesëmarrja në ankandin publik iu lejohet të gjithë pjesëmarrësve të regjistruar të cilët e paguajnë Tarifën/Depozitin e Regjistrimit, përpos stafit të UNHCR-së të cilët nuk lejohen që të marrin pjesë në këtë ankand në cilësinë e ofertuesve.